

STRAßEN 2K SPRAY



PËRSHKRIMI

STRABEN 2K SPRAY: Bojë sinjalistike dy komponente me bazë metilmetakrilati, me tharje të shpejtë për lyerjen e rrugëve, konform standardid EN 1871 dhe EN 1436.

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Për zonë me trafik të lartë
- Qëndrueshmëri e lartë e produktit.
- Rezištencë shumë e mirë mekanike
- Ngjitja e lartë dhe rezistente ndaj gërryerjes
- Koha e shpejtë e tharjes
- I lehtë në aplikim
- Rezistente ndaj lagështirës
- Performanca e lartë retro-reflektuese

PËRDORIME TË REKOMANDUARA

Bojë rrugësh e prodhuar posaçërisht për lyerjen e linjave të trafikut, për autostradat, rrugët, aeroportet, fabrikat, parkingjet, shesh lojërash, etj. Është gjithashtu një lidhës i shkëlqyeshëm për sferat e xhamit, të cilat mund të shtohen lehtësisht në shiritin e shënimit menjëherë pasi të aplikohet boja. Koha e tharjes ndryshon nga 15-20 minuta, në varësi të kushteve të motit dhe trashësisë së shtresës së aplikuar.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Rezina:	Metil Metakrilat
Raporti I miksimit B:Katalit	98:2
Densiteti ISO EN 2811-1	1,60 (+/- 0.05) Kg / Lt
Viskoziteti ISO EN 2431:2011	90 KU
Norma e hapjes	8-10 mL /Lt
Tharja UNE 135202	15 - 20 minuta
Reflektanca UNE 48073-2	β -0.85 LF7
Klasa	P7
Rrotullueshmeria	T3
Shikueshmeria naten ne te thate E RE	R5
Shikueshmeria naten ne te thate E vjeter	R3
Shikueshmeria naten ne lageshti	RW5
Shikueshmeria ditën E Re / E Vjeter	Q5
Mbetja e thate mbas ngurtësimit	> 99.8%
Ngjyrat	E disponueshem e bardhë, zezë, kuqe, blu, verdhë
Kordinatat e ngjyres	X – 0.328 Y – 0.348
Rezistenca ne rreshqitje	≥ 45
Indeksi i shkrijes	10

UDHËZIME APLIKIMI

Përgatitja e sipërfaqes:

Sipërfaqja e aplikimit duhet të jetë e pastër, pa yndyrë, vaj, ndryshk, mbetje bigorre (skorie), papastërti ose çdo ndotje tjetër që mund të ndikojë në ngjitjen ose performancën. Në çdo rast, por veçanërisht në rastin e mbivendosjes mbi sinjalistikën ekzistuese, rekomandohet më tej që zonat e testimit të lyehen për të siguruar aderim të mirë dhe/ose pajtueshmëri me nënshtresën.

Asfalti i vjetruar: – rekomandohet që asfalti dhe sipërfaqet e tjera të ngjashme të lihen të ngurtësohen plotësisht deri në 6 muaj përpara lyerjes. Provat testuese duhet të kryhen fillimisht në një zonë të vogël. Betoni dhe sipërfaqet e tjera çimentore, duke përfshirë betonin e lëmuar (powerfloat), të tustuar ose të fshirë, monoblokët dhe shtruesit (pavers) – sigurohuni që sipërfaqja të jetë e pastër dhe pa mbetje çimentoje. Ne rekomandojmë që përpara aplikimit të produktit të kryhet një metodë përgatitore e përshtatshme për vendndodhjen dhe sipërfaqen specifike, për të siguruar që sipërfaqja të jetë përgatitur siç duhet deri në nënshtresën e pastër dhe të shëndoshë. Shembuj të metodave të përgatitjes që mund të jenë të përshtatshme janë pastrimi me rërë (captive shot blasting), grirja me diamant, ashpërsimi (scabbling) ose rrafshimi (planing). Është kritike që vëmendja maksimale t'i kushtohet pastërtisë dhe punimit cilësor, pavarësisht nga metoda e përgatitjes së përdorur, pasi prania e çdo materiali të lirshëm, pluhuri, ndotjeje ose veshjeve të mëparshme ka të ngjarë të reduktojë aderimin e veshjeve të reja.

Betoni i ri duhet të lihet të ngurtësohet përpara lyerjes, pasi procesi i tharjes dhe përmbajtja e lagështisë mbetje mund të çojë në flluskimin ose shkëputjen e produktit (delamination) nëse lyhet shumë herët.

Udhëzimet e përzierjes:

Përzierja mirë bojen e ftohtë me spërkatje (Pjesa A). Përzierja mirë katalizatorin e lëngshëm. Materiali duhet të përzieret në raportin 98:2 me katalizatorin e lëngshëm në një makinë aplikimi të përshtatshme. Pas kësaj, përzierja mund të spërkatet direkt mbi sipërfaqe. Gjatë ndërprerjes së aplikimit, pastroni menjëherë sistemin e përzierjes dhe të gjitha pajisjet! Ju lutemi kini parasysh kohën shumë të shkurtër të përpunimit! Koka e përzierjes duhet të shpëlahet menjëherë. Për më tepër, ky lloj markimi duhet të kryhet vetëm në temperatura prej 20°C ose më pak.

APLIKIMI

Boja me spërkatje mund të aplikohet me atomizim me ajër (Air Spray) ose me sistemin Airless.

Kini parasysh:

Kurrë mos përzieri hollues (solvent) në plastikën e ftohtë me spërkatje! Përzieri mirë katalizatorin e lëngshëm. Materiali duhet të përzieret në raportin 98:2 me katalizatorin e lëngshëm në një makinë aplikimi të përshtatshme. Pas kësaj, përzierja mund të spërkatet direkt mbi sipërfaqe. Gjatë ndërprerjes së aplikimit, pastroni tërësisht sistemin e përzierjes dhe të gjitha pajisjet. Temperatura e ajrit nuk duhet të bjerë nën 5°C, ndërsa lagështia relative e ajrit nuk duhet të kalojë 75%. Temperatura e sipërfaqes duhet të jetë të paktën 3°C mbi pikën e vesës (dew point), por nuk duhet të kalojë 40°C. Aplikimi me makineri për sinjalizimin e rrugëve e sakte për të aplikuar dhe kontrolluar automatikisht dozimin dhe homogjenitetin (në përputhje me standardeve e UNE 135277-1 dhe EN 1781).

PAKETIMI

Komponenti A është i ambalazhuar në ambalazh metalik 30Kg

Kataliti është i ambalazhuar në ambalazh metalik 15Kg

SKADENCA DHE RUAJTJA

12 muaj, nëse ruhet në ambalazh origjinal dhe të pahapur. Të mbrohet nga ngricat dhe ekspozimi në diell.

INFORMACIONIMBI SHËNETIN, SIGURINË DHEMJEDISIN

Referojuni etiketimit të përmendur në kuti. Në rast se nevojiten më shumë informata, referojuni fletës së të dhënave të sigurisë materiale.

SHËNIME

- Rekomandohet të shmangni aplikimine produktit në temperatura nën 5°C ose pak para shiut.
- Mos e holloni kurrë produktin me ndonjë lloj tretësi ose holluesi.
- Pastroni pajisjet e aplikimit pas çdo përdorimi, edhe pas ndalesave të përkohshme me tretës ose hollues.

